



www.legjislacioni.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 17

Tiranë – E hënë, 29 maj 2017

PËRMBAJTJA

	Page
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 3831, datë 3.5.2017	Me objekt mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “ARBI-D” sh.a., me NIPT K62411001D, me seli në adresën Rruga “Bogdani” përballë Shkollës “Avni Rustemi” Tiranë-Shqipëri..... 3
Njoftim i Ministrisë së Financave nr. 7601, datë 26.5.2017	Për shitje..... 15



VENDIM

Nr. 3831, datë 3.5.2017

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga:

Gjyqtar: ERVIN POLLOZHANI

asistuar nga sekretare gjyqësore Gencjana Dada, sot më datë 3.5.2017, shqyrtoi në seancë gjyqësore publike, çështjen civile-tregtare me nr. 7306/1207 Regj. Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: SHOQËRIA “ARBI-D” sh.a. person juridik shqiptar, i regjistruar në QKR me NIPT K62411001D, me seli në qytetin e Tiranës, në adresën Rruga “Bogdani”, përballë Shkollës “Avni Rustemi”, e përfaqësuar nga MIMOZA CARA (MEMOÇI), me cilësinë e Administratores së Falimentimit të shoqërisë “ARBI-D” sh.a.

OBJEKTI: Mbyllje e procedurës së falimentimit të shoqërisë “ARBI-D” sh.a., me NIPT K62411001D, me seli në adresën Rruga “Bogdani” përballë Shkollës “Avni Rustemi” Tiranë-Shqipëri.

BAZA LIGJORE: Ligji Nr. 8901 dt. 23.5.2002 “Për falimentimin”, i ndryshuar, Neni 163 i tij.

Gjykata pasi administroi provat shkresore, dëgjoi përfaqësuesen me prokurë të debitorit, shoqërisë “Arbi-D” sh.a. av. Mariolla Ndina dhe administratoren e falimentit znj. Mimoza Cara të cilët u shprehen për përfundimin e procedurës së falimentimit për shkak të likuidimit të të gjithë pasurive të debitorit dhe shpërndarjen e të ardhurave të kreditorët e falimentit, anëtarët e Komitetit të Kreditorëve që ishin dakort me mbylljen e kësaj procedure dhe e shqyrtoi çështjen në tërësi, në përfundim të saj,

VËREN:

Se, shoqëria “Arbi-D” sh.a. fillimisht i është drejtuar kryesisht kësaj Gjykate, me kërkesën formale për hapjen e procedurave të falimentimit të Shoqërisë “Arbi-D” sh.a. bazuar në ligjin nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentin”, i ndryshuar, neni 15 e vijues i tij.

Ka rezultuar se, shoqëria “Arbi-D” sh.a. është një shoqëri tregtare e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit Tiranë në datë 1.11.2006. Selia e kësaj shoqërie është në Tiranë Rruga «Bogdani», përballë Shkollës «Avni Rustemi».

Kjo shoqëri ushtron aktivitetin tregtar në fushën e *lojrave të fatit*. Për këtë fushë të veprimtarisë së saj, shoqëria është licencuar si e tillë nga Ministria e Financave, Drejtoria e Lojrave të Fatit me Leje Ushtrimi Veprimtarie për Lojëra Fati për kategorinë «lojëra elektronike» nr. 43 dt. 11 shtator 2013, kjo me një afat 10-vjeçar.

Kapitali i shoqërisë është në masën 2,000,000 lekë e ndarë në 100 aksione me 20,000 lekë/aksioni. Aksioner i vetëm i shoqërisë është z. Arben Durmishi zotërues i 100% të vlerës së kapitalit.

Veprimtaria e kësaj shoqërie ka vazhduar rregullisht si e tillë deri në muajin dhjetor të vitit 2014, kohë pas së cilës rezultoi se shoqëria për shkak të vështirësive të saja financiare u vu në vështirësi likuidimi të detyrimeve ndaj të tretëve. Këto vështirësi kanë ardhur si pasojë e kushteve të vështira ekonomiko-financiare të cilat kanë dhënë një ndikim të madhë në uljen e rezultateve të saj në fushën e lojrave të fatit, gjobave të mëdha dhe për rrjedhojë ajo ka pësuar një përkeqësim të gjëndjes së saj financiare.

Krahas këtij fakti rezultoi se aktualisht kësaj shoqërie i ka përfunduar vlefshmëria e licencës së dhënë nga Ministria e Financave për këtë kategori lojrash fati që prej shtatorit të vitit 2013 dhe nuk ekziston më asnjë mundësi ligjore për rinovimin e saj. Kjo për arsyen e thjeshtë se neni 5 i ligjit nr. 155/2015 “Për lojrat e fatit në Republikën e Shqipërisë” e përjashton kategorinë e lojrave elektronike nga kategoritë e lojrave të fatit të parashikuara dhe për pasojë nuk ekziston asnjë mundësi efektive për vazhdimësinë e kësaj veprimtarie.

Situata financiare e shoqërisë ka sjellë pasojë me mbingarkesë të borxheve që ka, pasi ajo nuk është në gjëndje të tillë financiare që mund të kryej shlyerjen e detyrimeve të tjera financiare që kanë afate maturimi të mëvonshme.

Gjatë kësaj periudhe, sipas pohimit të përfaqësueses së palës kërkuese, kundër shoqërisë “Arbi – D” sh.a. kanë filluar disa procese administrative për pagime të detyrimeve me natyrë tatimore e doganore të cilat nuk mund të ndiqen për t’u ankimuar nga ana e shoqërisë për mungesë të likuiditeteve dhe gjëndjes së saj të rënduar financiare për shkak të ngarkesës me borxhe.



Krahas kësaj, paaftësia e saj paguese shtrihet edhe në një të ardhme të afërt pasi nuk është në gjendje të paguaj ose shlyejë detyrimet që ka në datën e maturimit.

Kështu rezulton nga aktet e paraqitura në gjykim se deri më dt. 31.12.2015, shoqëria “Arbi-D” sh.a. ka detyrime për të paguar kundrejt të tretëve në vlerën totale 359.110.001 lekë.

Shoqëria ndodhet në gjendje të mbingarkesës me borxhe pasi vlerat e pasurive të saj nuk mbulojnë detyrimet ndaj të tretëve dhe në bazë të rrethanave, konkretisht referuar të ardhurave për vitin 2015 ato kanë qenë në masën 0 lekë. Shoqëria ka arritur në një situatë financiare që nuk premtan apo garanton shlyerjen e tyre.

Kështu, sipas provave shkresore të paraqitura në gjykim evidentohet se sipas shkresës nr. 497/1 prot. dt. 23.2.2016 rezulton se ndaj Autoritetit të Mbikqyrjes së Lojrave të Fatit kjo shoqëri ka detyrimin në total (detyrim gjobe+detyrim kamate) në vlerën 3.000.000 lekë.

Sipas shkresës nr. 2004/1 Prot. dt. 22.2.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Dega e Doganës Tiranë kjo shoqëri rezulton debitore në shumën totale (detyrim+penalitet +interesave) 277, 884, 509 lekë.

Sipas shkresës së Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë nr. 549 prot. dt. 7.3.2016 kjo shoqëri rezulton debitore ndaj kësaj drejtorie në masën 474 lekë për tatim mbi fitimin, 40. 000 lekë për tatim mbi lojrat e fatit, gjobë për mosmbajtje të saktë të librave në vlerën 10. 000 lekë. Nuk ka detyrime për sigurimet shoqërore&shëndetësore, tatim në burim, tatim mbi fitimin dhe Tvsh-në.

Më tej nga administratori i shoqërisë në referim të nenit 15 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentin” janë lëshuar/nënshkruar deklaratat sipas së cilave të dhënat e pasqyruara në pasqyrat financiare dhe shënimet përkatëse të shoqëruara bashkë me listën e aktiveve afatgjata dhe inventarët janë të saktë të plotë dhe përfaqësojnë situatën reale të shoqërisë; të dhënat dhe pasqyrat analitike të aktiveve afatgjata dhe të inventarëve janë në pronësi të shoqërisë dhe nuk janë përdorur për tu lënë si mjet sigurimi apo janë ngarkuar me barrë të çfarëdo lloji tipi tjetër.

Më tej, nga ZVRPP Tiranë, rezultoi e provuar me shkresën dt. 30.5.2016 se kjo shoqëri nuk ka të regjistruar në pronësi të saja asnjë pasuri të paluajtshme.

Me vërtetimin nr. 612 prot. dt. 8.6.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Drejtoria Rajonale Tiranë, rezulton se kjo shoqëri nuk është debitore ndaj kësaj drejtorie për taksat vjetore të mjeteve të përdorura prej saj, gjoba të kontrollit teknik, apo gjoba të kontrollit në rrugë. Mjetet që kjo shoqëri ka patur në pronësi rezultojnë të shitura prej saj sipas kontratave të bashkangjitura vërtetimit.

Po kështu, sipas gjendjes së llogarisë së kësaj shoqërie, në Bankën Kombëtare Tregtare sh.a. rezulton se gjendja e llogarisë së kësaj shoqërie pranë kësaj banke si në valutë dhe në lekë, është në vlerën 0.

Nisur nga këto rrethana fakti dhe provash, për shkaqet e sipërpërmendura, pala kërkuuese Shoqëria “Arbi-D” sh.a., me cilësinë e debitorit i është drejtuar me iniciativën e saj, kësaj gjykate me kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit.

Në lidhje me parashikimet ligjore në përputhje me rastin konkret, gjykata vëren se: Neni 1 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin” (i ndryshuar) parashikon shprehimisht se: “Ky ligj ka për objekt të caktojë rregulla të detyrueshme, të njëjta dhe të barabarta për shlyerjen e detyrimeve të debitorëve në një procedurë falimentimi.”

Ndërsa, në nenin 2 të tij parashikohet qëllimi i procedurës së falimentimit: “1. Procedura e falimentimit ka qëllim të shlyejë, në mënyrë kolektive, detyrimet e debitorit nëpërmjet likuidimit të të gjitha pasurive të tij dhe shpërndarjes së të ardhurave, ose, në rastin e një plani riorganizimi, nëpërmjet arritjes së një marrëveshjeje tjetër, me synim kryesor ruajtjen e veprimtarisë së tij. 2. Çdo debitori të ndershëm, nëpërmjet procedurës së falimentimit, i jepet mundësia të shkarkohet nga pjesa e mbetur e detyrimeve.

Neni 13 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin” (i ndryshuar) parashikon: “1. Procedura e falimentimit hapet vetëm me shkak. 2. Gjendja e paaftësisë paguese përbën shkak të përgjithshëm për hapjen e procedurës së falimentimit. Debitori vlerësohet i paaftë për të paguar nëse nuk është në gjendje të paguajë detyrimet në datën e maturimit. Paaftësia paguese prezumohet se ekziston nëse debitori nuk kryhen pagesat.....4. Mbingarkesa me borxhe përbën shkak për hapjen e procedurës së falimentimit në rastin e një personi juridik. Debitori ndodhet në gjendjen e mbingarkesës me borxhe kur



vërtetohet se pasuritë e tij nuk mbulojnë detyrimet ndaj të tretëve dhe në bazë të rrethanave pas vlerësimit të pasurive të debitorit nuk është më mundësia për vazhdimësinë e veprimtarisë... ”

Neni 14/1 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin” (i ndryshuar) parashikon: “1. Procedura e falimentimit hapet vetëm me kërkesën e debitorit ose kreditorëve. Në rastin e personave juridikë procedura e falimentimit mund të hapet edhe me kërkesën e organeve tatimore kur rezultojnë një bilanc me humbje për një periudhë tre vjeçare... ”

Neni 15 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin” (i ndryshuar) parashikon-Kërkesa e debitorit: “1. Drejtorët, zyrtarët, ortakët apo aksionarët e shoqërisë, ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit, së bashku me kërkesën për hapjen e procedurës së falimentimit ose menjëherë pas dorëzimit të saj, duhet të paraqesin: a) listën e pasurive dhe të të ardhurave që ka së bashku me një deklaratë, ku të shënohet vlera e çdo sendi dhe fakti nëse ky send është përdorur si mjet sigurimi, ose nëse është ngarkuar me barrë si i tillë; b) listën e kreditorëve me emrat, adresat dhe shumat, që përbëjnë detyrimin përkatës ndaj tyre. 2. Dokumentacioni i paraqitur nga drejtorët, zyrtarët, ortakët apo aksionarët e shoqërisë, ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit, duhet të përmbajë edhe një deklaratë, përmes së cilës vërtetohet se përmbajtja e dokumenteve të mësipërme është e plotë dhe e saktë.

3. Nëse drejtorët, zyrtarët, ortakët apo aksionarët e shoqërisë, ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit, nuk i kanë dorëzuar të gjitha deklaratat dhe dokumentet e përmendura në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit i kërkon atij plotësimin e tyre. Nëse drejtorët, zyrtarët, ortakët apo aksionarët e shoqërisë, ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit, nuk e zbatojnë kërkesën e mësipërme brenda 15 ditëve, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit rrëzon kërkesën e drejtorëve, zyrtarëve, ortakëve apo aksionarëve të shoqërisë, ndaj së cilës është hapur procedura e falimentimit, për hapjen e procedurës së falimentimit”.

Sa më sipër u parashtrua nga gjykata, rezultoi se nga pala kërkuuese të gjitha këto akte formale detyruese u paraqitën si të tilla në formën dhe përmbajtjen e kërkuar nga ligji.

Neni 18/4 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin” (i ndryshuar) parashikon: “Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit brenda afateve të treguara në pikën 3 të këtij neni vendos : c) pranimin e kërkesës dhe hapjen e procedurave të falimentimit”.

Neni 26 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin” (i ndryshuar) parashikon: “1. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos hapjen e procedurës së falimentimit kur çmon se janë shkaqet dhe kushtet e parashikuara në këtë ligj për hapjen e procedurës së falimentimit. 2. Vendimi përhapjen e procedurës së falimentimit përmban: a) emrin, mbiemrin dhe vendbanimin e debitorit në rastin e personave ose emrin, llojin e veprimtarisë dhe selinë në rastin e personave juridikë. b) emrin, mbiemrin dhe adresën e administratorit të falimentimit; c) orën e saktë kur është hapur procedura e falimentimit. c) të dhënat e parashikuara në nenin 27 dhe 29 të këtij ligji; d) urdhërimin e detyrimit të publikimit të vendimit në internet, në faqen zyrtare të gjykatës, të Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit dhe të organit tatimor përkatës..... 4. Së bashku me hapjen e procedurës së falimentimit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos emërimin e administratorit të falimentimit”.

Në përfundim pas analizës së faktit, pretendimeve të palës kërkuuese dhe analizës së parashikimeve në ligj, gjykata vëren se bazuar në nenin 16 të Kodit të Procedurës Civile, ajo duhet të bëjë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët.

Procedura e falimentimit përfaqëson procesin e likuidimit të një subjekti që ndodhet në kushtet e paaftësisë paguese apo mbingarkesës së tij me borxhe. Kjo procedurë ka për qëllim likuidimin e subjektit, nëse gjykohet se shitja e pasurive të tij, do të jetë me përfitim për kreditorët ose krijimin e një plani shëndetësimi për këtë subjekt, në rast se arrihet në përfundimin se një veprim i tillë është i mundur.

Fillimi, në rrugë gjyqësore, i procedurës së falimentimit realizohet vetëm në kushtet e ekzistencës së shkakut të falimentimit:

a) gjëndje e paaftësisë paguese të subjektit që i drejtohet kërkesa për falimentim ose/dhe

b) mbingarkesës së subjektit me borxhe.

Legjitimitimin aktiv për fillimin e procedurave gjyqësore të falimentimit, e gëzon kreditori, debitori, si dhe organet tatimore, në rast konstatimi të humbjeve në bilanc të subjektit për një periudhë fiskale tre vjeçare. Në rastet kur kërkesa për hapjen e procedurave të falimentimit paraqitet nga vetë subjekti debitor, ky i fundit duhet t’i evidentojë gjykatës: listën e



pasurive dhe të të ardhurave që ka së bashku me një deklaratë, ku të shënohet vlera e çdo sendi dhe fakti nëse ky send është përdorur si mjet sigurimi, ose nëse është ngarkuar me barrë si i tillë; listën e kreditorëve me emrat, adresat dhe shumat, që përbëjnë detyrimin përkatës ndaj tyre; një deklaratë, përmes së cilës vërtetohet se përmbajtja e dokumenteve të mësipërme është e plotë dhe e saktë.

Në lidhje me çështjen objekt gjykimi, Gjykata ka arritur në përfundimin se pala kërkuese legjitimohet të paraqesë këtë kërkesë, pasi ka cilësinë e debitorit në procedurën e falimentimit dhe ndaj pasurisë së saj vlerësohet se ka një interes me karakter pasuror.

Në zbatim të parashikimeve të nenit 18 të ligjit, me qëllim për të hetuar rreth pretendimeve të kërkuarit për ekzistencën e gjëndjes së falimentimit të Shoqërisë “Arbi-D” sh.a, gjykata ka caktuar si administratore të përkohshme të falimentimit znj. Mimoza Cara (Memoçi), të cilës iu caktuan si detyra të verifikojë ekzistencën e shkakut/shkaqeve të hapjes së procedurës së falimentimit, në drejtim të gjëndjes së paaftësisë paguese të subjektit apo/dhe mbingarkesës së tij me borxhe, të verifikojë nëse pasuritë e debitorit mbulojnë shpenzimet e procedurës së falimentimit, të verifikojë nevojën e marrjes së masave për sigurimin e pasurisë si dhe mundësinë për vijimësinë e veprimtarisë tregëtare të debitorit.

Nga raporti i paraqitur nga administratorja e përkohshme e falimentimit u përshkrua se: Aktivët e shoqërisë “Arbi – D” sh.a. deri me dt. 31.12.2015 janë: Mjetet monetare 206,829 lekë ose 0,4% e totalit të aktivitetit; aktive afatshkurtra 8,863,701 lekë ose 20.76 % e totalit të aktivitetit; Inventari 4,570,409 lekë ose 10.7 % e totalit të aktivitetit; aktivët afatgjatë 29,063,856 lekë ose 68.06% e totalit të aktivitetit.

Detyrimet e shoqërisë “Arbi-D” sh.a. deri me dt. 31.12.2015 janë: furnitorë për mallra e shërbime 74,737,049, lekë ose 20.64% të totalit të detyrimeve; detyrime ndaj personelit 3,417,329 lekë ose 0.94%; detyrime tatimore për sigurimet shoqërore 20,640 lekë ose 0% të totalit të detyrimeve; detyrime tatimore 50,474 lekë ose 0 % të totalit të detyrimeve; detyrime ndaj NJMLF 3,000,000 lekë ose 0.83 %; detyrime ndaj Doganës Tiranë 277,884,509 lekë ose 76.75 % dhe detyrime ndaj ortakëve 2,960,279 lekë ose 0.84 % e detyrimeve.

Referuar bilancit të shoqërisë për vitin 2015, raporti i aktiveve me detyrimet është 1: 8,478 pra detyrimet janë

përafërsisht 8.5 herë më të mëdha se aktivët. Raporti i mësipërm tregon se vlera e aktiveve është e pamjaftueshme për likuidimin e detyrimeve të maturuara deri me dt. 31.12.2015.

Sa më sipër rezultuan këto përfundime: Ekzistenca e shkakut të hapjes së procedurës së falimentimit të Shoqërisë “Arbi – D” sh.a është reale. Nga provat, sipas aktit, rezulton se Shoqëria është në gjëndje të paaftësisë paguese, për detyrimet e njohura prej saj ndaj kreditorëve (referuar bilanceve dhe deklaratave të dorëzuara në gjykatë);

Sipas gjëndjes së likuiditetit në deklaratat e dt. 15.3.2016 rezulton se debitori nuk ka mjete paguese të mjaftueshme nuk përmbush në afatin e maturimit detyrimin ndaj kreditorëve të tij dhe si rrjedhojë plotëson kushtin e gjëndjes së paaftësisë paguese. Detyrimet e mësipërme janë konsideruar nga debitori si të maturuara dhe është përgjegjësi e tij llogaritja e datës së maturimit të detyrimeve. Shoqëria nuk i ka përmbushur në kohë dhe tërësisht këto detyrime. Shoqëria nuk është në gjëndje të paguajë detyrimet që kanë datën e maturimit dhe të përmbushë tërësisht këto detyrime kur të maturohen. Mbingarkesa me borxhe, raporti i aktiveve me detyrimet është 1:8,478 pra detyrimet janë 8.5 herë më të mëdha se aktivët.

Pasuritë e debitorit mbulojnë (janë të mjaftueshme) shpenzimet e procedurës së falimentimit, kjo sipas analizës së bërë nga administratorja e përkohshme e falimentit në lidhje me mjetet monetare, arkë banke, klientë për mallra dhe shërbime si dhe materiale të ndryshme.

Debitori nuk ka mundësi të vazhdojë veprimtarinë tregëtare për shkak të pamundësisë ligjore për rinovimin e lejes së ushtrimit të aktivitetit.

Në lidhje me nevojën e marrjes së masave për sigurimin e pasurisë, administratorja e përkohshme e falimentimit ka çmuar se në fillim duhet të evidentohet, vërtetohet dhe vlerësohet pasuria në momentin e këtij verifikimi dhe pastaj të merren masa për sigurimin e saj.

Sa më lart dhe në përfundim të hetimit gjyqësor, në kushtet kur vërtetohet ekzistenca e dy prej shkaqeve të hapjes së procedurës së falimentimit siç janë mbingarkesa me borxhe dhe paaftësia paguese, gjykata, në bazë të neneve 18/4/c dhe 26 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, të ndryshuar, me vendimin e saj dt. 17.6.2016 ka vendosur:



1. Pranimin e kërkesës së kërkuarit, Shoqëria “ARBI - D” sh.a.

2. Hapjen në orën 09: 45, të datës 17. 06. 2016, të procedurës së falimentimit të Shoqërisë “ARBI - D” sh.a., me administrator z. Kozma Biqiku, me seli në adresën : Rruga “Bogdani” përballë Shkollës “Avni Rustemi”, Tiranë, Shqipëri.

3. Emërimin si administratore të falimentimit, për Shoqërinë “ARBI - D” sh.a., të znj. Mimoza Cara (Memoçi), e licencuar nga Ministria e Drejtësisë, me licencën Nr. 13, datë 15. 10. 2012, me Adresë: Pallati i Kulturës, kati i tretë nga parkimi, Tiranë me NIPT K31414020T dhe me Cel: 069 20 91 209.

4. Të gjithë kreditorët e Shoqërisë “ARBI - D” sh.a., të paraqesin pranë administratores së falimentimit, pretendimet e tyre brenda 90 ditëve nga dita e shpalljes së këtij vendimi.

5. Të gjithë krëditorët e Shoqërisë “ARBI - D” sh.a., të njoftojnë menjëherë administratoren e falimentimit, për pretendimet dhe të drejtat e tyre të siguruar mbi pasuritë e debitorit.

6. Personat që kanë detyrime ndaj debitorit, Shoqërisë “ARBI - D” sh.a., t’ia paguajnë dhe shlyejnë ato administratores së falimentimit znj. Mimoza Cara (Memoçi).

7. Mbledhja e kreditorëve të Shoqërisë “ARBI - D” sh.a., për raportim, të mbahet brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

8. Mbledhja e kreditorëve të Shoqërisë “ARBI - D” sh.a., për verifikim, të mbahet brenda 60 ditëve nga përfundimi i afatit të depozitimit të pretendimeve.

9. Urdhërohet publikimi i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të Shoqërisë “ARBI - D” sh.a., në Buletinin e Njoftimeve Publike.

10. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të Shoqërisë “ARBI - D” sh.a., t’i njoftohet administratores së falimentimit të Shoqërisë “ARBI - D” sh.a. znj. Mimoza Cara (Memoçi).

11. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të Shoqërisë “ARBI - D” sh.a., t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Biznesit.

12. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të Shoqërisë “ARBI - D” sh.a., t’i dërgohet Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, me qëllim njoftimin e të gjitha Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe kryerjen e veprimeve konform nenit 31 të ligjit Nr. 8901, datë 23. 05. 2002 “Për falimentimin”, i ndryshuar.

13. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të Shoqërisë “ARBI - D” sh.a., t’i dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë të Republikën e Shqipërisë.

14. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të Shoqërisë “ARBI - D” sh.a., t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

15. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të Shoqërisë “ARBI - D” sh.a., t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

16. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të Shoqërisë “ARBI - D” sh.a., t’i dërgohet Autoritetit Rrugor Kombëtar.

17. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të Shoqërisë “ARBI - D” sh.a., t’i dërgohet Agjencisë së Mbikqyrjes së Falimentit pranë Ministrisë së Drejtësisë.

18. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të Shoqërisë “ARBI - D” sh.a., t’i dërgohet Dhomës Kombëtare të Noterëve.

19. Urdhërohet publikimi dy herë i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të Shoqërisë “ARBI - D” sh.a., në internet, në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

20. Urdhërohet publikimi dy herë i vendimit, të shkurtuar, për hapjen e procedurave të falimentimit të Shoqërisë “ARBI - D” sh.a., në dy gazeta me qarkullim kombëtar Gazeta “Panorama” dhe Gazeta “Shekulli”.

21. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kërkuarit.

22. Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve, afat ky që fillon nga e nesërmeja e shpalljes së tij.

Ndaj këtij vendimi gjyqësor i cili është menjëherë i ekzekutueshëm nuk është bërë ankim dhe si i tillë ai ka marrë formë të prerë.

Me hapjen e procedurës së falimentit dhe marrjen formë të prerë të vendimit gjyqësor, është proceduar më tej me respektimin e urdhërimeve të ligjit në fuqi si dhe të vetë vendimit gjyqësor Nr. 7306/2016.

Nga ana e administratores së falimentit janë depozituar në gjykatë të gjitha listat e përcaktuara në Nenin 119 e vijues të ligjit për falimentimin, në respektim dhe të afateve kohore të nenit 122 të këtij ligji. Ashtu sikurse është përcaktuar dhe në dispozitivin e vendimit Nr. 7306/2016: “Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë” Arbi-D” sh.a. për raportim të mbahet brenda 90 ditëve nga dita e shpalljes së këtij vendimi”.

Është mbajtur mbledhja e kreditorëve për raportim në dy data, me datë 13.9.2016 dhe dt. 15.9.2016, njoftimet e të cilave i janë bërë kreditorëve me njoftime secilit prej tyre (sipas



shkresave të dërguara nga administratorja e falimentimit) si dhe me njoftimin në faqen zyrtare publike të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me datë 7.9.2016 dhe dt. 13.9.2016 (kopje e së cilit ndodhet në dosjen gjyqësore dhe që plotëson kërkesat e nenit 9, pika 5, të ligjit për falimentimin).

Në mbledhjet e raportimit, pjesëmarrja dhe ecuria e së cilës pasqyrohet në procesverbalin e mbajtur në të, administratorja e falimentit ka mbajtur raportin përkatës të datës 13.9.2016 dhe dt. 15.9.2016 në të cilin raporton mbi gjendjen ekonomike të shoqërisë debitore, shkaqet e falimentimit dhe pasi paraqet situatën në mënyrë të detajuar shprehet se: *“Vazhdimësia e aktivitetit të shoqërisë është e pamundur në kushtet kur shoqëria është e mbingarkuar me borxhe si dhe ka ndërprerë aktivitetin e saj”*.

Nga pjesëmarrësit në mbledhje raporti u gjet i drejtë; nuk u paraqit plan riorganizimi si dhe nuk u pa e mundur ekzistenca e një plani të riorganizimit; gjithashtu në këtë mbledhje u procedua dhe me caktimin nga mbledhja e kreditorëve e komitetit të kreditorëve i përbërë nga tre anëtarë. Vendimet në mbledhje u morën konform nenit 63 të ligjit për falimentimin.

Në respektim të detyrimeve ligjore administratorja e falimentimit ka depozituar në gjykatë dhe listat e “pretendimeve të kreditorëve” të cilët kanë paraqitur pretendimet e tyre me shkrim (si një kërkesë e përcaktuar shprehimisht në ligj lidhur me paraqitjen e pretendimeve me shkrim) brenda afatit kohor të përcaktuar në vendimin gjyqësor të Nr. 7306/2016; *“Të gjithë kreditorët e shoqërisë” ARBI-D”sh.a. të paraqesin pranë administratorit të falimentimit pretendimet e tyre, konform nenit 141 të ligjit 8901 datë 23.5.2002, i ndryshuar brenda 90 ditëve nga dita e shpalljes së këtij vendimi”*.

si dhe ato të paraqitura jashtë këtij afati kohor deri përpara mbledhjes së kreditorëve për verifikim të pretendimeve të tyre, e cila është mbajtur më datë 11. 11. 2013 (sipas urdhërimeve të vendimit gjyqësor Nr. 7306/2016 dhe atyre ligjore: *“Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “ARBI-D”sha për verifikim të mbahet brenda 60 ditëve nga përfundimi i afatit për depozitim të pretendimeve”*.

E drejta për paraqitjen dhe trajtimin e pretendimeve me shkrim jashtë afatit të përcaktuar në vendimin gjyqësor të hapjes së procedurës së falimentimit rezulton nga

përmbajtja e nenit 144 të ligjit për falimentin sipas të cilit *“Gjatë mbledhjes së verifikimit shqyrtohen dhe pretendimet e paraqitura pas përfundimit të afatit për depozitim”*.

Në mbledhjen e verifikimit të pretendimeve e mbajtur më datë 11. 11. 2016, e cila është njoftuar për secilin prej kreditorëve me njoftime të veçanta si dhe me njoftimin në faqen zyrtare publike të gjykatës (njoftim i datës 3.11.2013 sipas shkresave të ligjit që plotëson dhe kërkesat e nenit 9, pika 5, të ligjit për falimentimin), është proceduar me verifikimin e pretendimeve të depozituara.

Në këtë mbledhje, e cila pasqyrohet në procesverbalin e mbajtur të datës 11. 11. 2016-ku gjejmë prezencën dhe vendimet e marra, janë paraqitur konform nenit 144 të ligjit për falimentimin *“Gjatë mbledhjes së verifikimit shqyrtohen dhe pretendimet e paraqitura pas përfundimit të afatit për depozitim”* dhe pretendime me shkrim të kreditorëve të shoqërisë “ARBI-D” sh.a. dhe më konkretisht të: Degës së Doganës Tiranë, Bashkisë Tiranë Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria Rajonale Tatimore, Autoriteti i Mbikqyrjes së Lojrave të Fatit, Paga e administratorit të shoqërisë me cilësinë e punëmarrësit, si dhe e shoqërisë “Automotive” Lushnjë.

Në këtë mbledhje verifikimi u morën në shqyrtim të gjithë pretendimet e kreditorëve të paraqitura me shkrim (si kërkesë e ligjit) duke u lënë jashtë shqyrtimit pretendimet e pa paraqitura me shkrim të kreditorëve të shoqërisë ARBI-D sh.a. (të cilët figurojnë si të tillë në listën e kreditorëve të saj). Këta kreditorë për sa u trajtua më lart konsiderohen të njoftuar në lidhje me të gjithë procedurën e ndjekur duke pasur të gjitha mundësitë për paraqitjen me shkrim të pretendimeve të tyre.

Kështu me cilësinë e akteve zyrtare dhe private janë evidentuar në raport: shkresa nr. 9662 dt. 10.9.2012 i Drejtorisë së Doganës Tiranë; shkresën e Bashkisë Tiranë-DPTTV me nr. 113125/1 prot. datë 6.7.2016; shkresën e Njësisë së Mbikqyrjes së Lojrave të Fatit nr. 3865/3 dt. 4.8.2016; kërkesën me shkrim të administratorit të shoqërisë për pagën e papërfutur për periudhën 2013 deri maj 2016, fatura tatimore e shoqërisë “Automotive” Lushnjë.



Në mbledhjen për verifikim të pretendimeve u shqyrtuan dhe verifikuan të gjithë pretendimet e kreditorëve bazuar në provat e paraqitura dhe verifikimi i tyre nuk u kundërshtua nga administratori i falimentit, nga kreditorët e falimentit pjesëmarrës (komiteti i kreditorëve) si dhe as nga vetë debitori, e në pasojë këto pretendime të verifikuara konsiderohen/vlerësohen të vërtetuara (neni 145 i ligjit për falimentimin).

Sa më lart gjen pasqyrim të plotë në tabelën e pretendimeve të verifikuara dhe të vërtetuara të kreditorëve e datës 11.11.2016 e përpiluar nga administratorja dhe e konfirmuar-nënshkruar dhe nga gjykata në përfundim të kësaj mbledhje verifikimi.

Mbas mbledhjes për verifikim të datës 11.11.2016 nga ana e administratorës së falimentimit duhet të fillonte ripagimi i kreditorëve në bazë të përcaktimeve të nenit 150 të ligjit për falimentin, ndërkohë që likuidimi i pasurisë së masës së falimentit fillon pas mbledhjes për raportim (neni 127).

Duhet të theksojmë se në rastin konkret objekt gjykimi kemi të bëjmë me kreditorë të falimentit dhe jo më kreditorë të siguruar-nuk u paraqitën pretendime në lidhje me të drejta të siguruara; gjithashtu nisur nga raporti mes detyrimeve ndaj të tremeve në vlerën 285,093,829 lekë dhe vlerë totale të pasurisë/aktiveve në masën 42,704,794 lekë për shoqërinë debitorë nga gjykata nuk u kërkuar me shkrim pretendimet e kreditorëve të rangjeve më të ulëta (në rastin konkret paraqiten vetëm në lidhje me interesat e fituara mbi shumat e pretendimeve të kreditorëve të falimentit).

Në lidhje me pretendimet e kreditorëve nuk pati pretendime të tjera të paraqitura pas mbledhjes për verifikim të cilat të diktonin një mbledhje të posaçme verifikimi apo verifikimin me procedurë me shkrim.

Në mbledhjen e verifikimit të pretendimeve pasi nuk pati kundërshtim nga subjektet e sipërcituara sipas ligjit dhe në pasojë këto pretendime të verifikuara u konsideruan të vërtetuara (neni 145 i ligjit) dhe nga ana e administratorës së falimentit u hartua dhe tabela e pretendimeve të verifikuara dhe vërtetuara të kreditorëve të shoqërisë ARBI-D sh.a., e cila mban datën 11.11.2016 (paraqiten të dhëna të detajuara).

Po kështu në këtë mbledhje u vendos që nga ana e administratorës së falimentimit të procedohej me procedurën e ankandit të hapur për shitjen e aseteve të shoqërisë (makinetave të lojrave të fatit të inventarizuara).

Në ecurinë e veprimeve administratorja e falimentit ka proceduar me grumbullimin e masës së falimentit nëpërmjet arkëtimit nga debitorët e “Arbi-D” sh.a. si dhe të shoqërive të tjera debitore ndaj saj të detyrimeve të evidentuara dhe shitjen e aseteve të kësaj shoqërie, të cilat janë evidentuar gjatë mbledhjeve respektive të zhvilluara në periudhën 13.12.2016-06.2.2017). Gjatë këtyre mbledhjeve janë evidentuar hapat e ndërmarra nga administratoeja e falimentimit për kryerjen e procedurës së ankandit të hapur për shitjen e makinetave të inventarizuara, rikthimin e shumës së kredisë së marrë kryesisht nga kreditori DPTTV, sqarimin formal me Njësinë e Mbikqyrjes së Lojrave të Fatit për asgjësimin e 32 aparaturave elektronike të sekuestruara nga ana e kësaj Njësie në bazë të ligjit nr. 10033 dt. 11.12.2008 “Për lojrat e fatit” dhe udhëzimit të Ministrit të Fianacave nr. 46 dt. 13.11.2009 “Për përcaktimin e procedurave për konfiskimin, magazinimin dhe shkatërrimin e mjeteve të lojrave të fatit”.

Më tej është proceduar me paraqitjen në gjykatë të kërkesës për miratimin e shpërndarjes së parë të masës së falimentimit të akumuluar kundrejt kreditorëve si dhe miratimin e shpenzimeve të procedurës së falimentit si dhe të masës së falimentit, kërkesë e datës 6.2.2017 bërë nga administratorja e falimentimit.

Veprimtaria e saj gjen pasqyrim të plotë në “Raportin e administratorit të Falimentit gjatë procedurës së falimentit dhe gjendja e masës së falimentit për periudhën 15.6.2016 deri më datë 20.12.2016”, i plotësuar me procesverbalin e dt. 9.1.2017. Bashkangjitur këtij raportit dhe proceverbali është dokumentacioni shoqërues justifikues dhe ky raport është nënshkruar dhe miratuar dhe nga anëtarët e komitetit të kreditorëve.

Administratorja e falimentit përcaktoi dhe pjesën e pretendimit që do të paguhej kreditorëve që janë marrë parasysh.

Në dokumentacionin shoqërues të kërkesës administratorja pasqyroi shumën që do të shpërndahej te kreditorët në masën 10.173.550 lekë; administratorja pasqyroi të gjithë masën e



falimentit në vlerën 12.870.530 lekë, shpenzimet e procedurës së falimentit 1.665.679 lekë, shpenzimet e tjera administrative të masës së falimentit 1.031.302, ku zbriten nga masa e falimentit shpenzimet e procedurës dhe të tjera administrative të masës së falimentit (nenet 36, 37 dhe 38 të ligjit) dhe me të drejtë administratorja ka nxjerrë shumën përfundimtare që do u paguhet kreditorëve.

Në respektim të nenit 150 të ligjit administratorja i është referuar nenit 605 të K. Civil në lidhje me përcaktimin e pjesëve të pretendimit që do tu paguhen kreditorëve të falimentit.

Neni 603 i K. Civil jep nocionin e preferimit si një e drejtë që ligji e jep duke pasur parasysh shkaktun e kredisë dhe kreditë që caktohen si të preferuara kanë përparësi nga gjithë kreditë e tjera. Kjo do të thotë se fillimisht shpërndarja duhet të bëhet në rradhet e përcaktuara në nenin 605 të K. Civil dhe në rast se plotësohen të gjithë pretendimet e kreditorëve sipas rradhës së preferimit do të kalohet më pas te kreditorët që janë jashtë këtyre rradheve të preferimit.

Po sipas nenit 603 të K. Civil midis shumë kredive të preferuara përparësia në ekzekutim përcaktohet nga ligji sipas llojit të preferimit.

Në nenin 604 të K. Civil bëhet rregullim dhe për kreditë që janë një lloj të preferuara, të cilat konkurrojnë ndërmjet tyre në proporcion me shumën e secilës kredi.

Nisur nga ky rregullim ligjor si dhe referuar shkaktun të kredisë, i cili përcakton llojin si dhe rradhën e preferimit, administratorja e falimentit më të drejtë ka cituar se nuk kemi kreditorë sipas pikës “a” të nenit. Kemi kreditor të siguruar sipas pikës “c” për pagën e një punonjësi në funksionin e administratorit të shoqërisë në vlerën 592.560 lekë. Kemi kreditorë të siguruar sipas pikës “c” për detyrimet ndaj organeve tatimore për sigurimet shoqerore të papaguara nga shoqëria në vlerën 20.640 lekë. Kemi kreditorë sipas përcaktimit të pikës “dh”, kreditë e shtetit që rrjedhin nga detyrime ndaj buxhetit të shtetit të parashikuara në ligj, për Doganën Tiranë si dhe për taksat vendore për vitin 2016 në shumën 57,084.079 lekë.

Kemi kreditorë të siguruar sipas pikës “ë” pagën e një punonjësi në funksionin e administratorit të shoqërisë në vlerën 3.121. 049

lekë. Kreditorët e tjerë të pa klasifikuar në asnjë nga pikat e nenit 605 të K. Civil janë përfshirë në përshkrimin gjorbë për vlerën 198.426.581 lekë dhe interes në shumën 25. 848. 920 lekë.

Midis këtyre kreditorëve dhe në zbatim të nenit 604 të K.Civil, pasi kemi të bëjmë me kreditë që janë njëlloj të preferuara, është bërë përcaktimi i pjesës së pretendimeve për secilin kreditor në proporcion me shumën e secilës kredi. Administratorja jep në mënyrë të shprehur pjesën takuese të pretendimeve në vlerë leku për secilin kreditor të pikës dh) të nenit 605 të K. Civil (tabela e datës 20.12.2016).

Në kushtet kur nuk plotësohet tërësisht pjesa e pretendimeve për këta kreditorë kuptohet që nuk mund të bëhet fjalë për ripagim të kreditorëve të tjerë jashtë kësaj rradhe preferimi dhe aq më tepër kreditorë të rangjeve më të ulëta.

Kjo shpërndarje e parë e masës së falimentimit është miratuar dhe nga komiteti i kreditorëve sipas rregullimeve të nenit 150, pika 3, të ligjit për falimentin (është nënshkruar prej tyre raporti i datës 20.12.2016 dhe tabela përkatëse e datës 9.1.2017).

Sa më lart administratorja e falimentit ka përcaktuar dhe vlerën e shpenzimeve të procedurës së falimentit dhe atë të shpenzimeve të tjera administrative, të cilat shlyhen nga masa e falimentit para pretendimeve të kreditorëve të masës së falimentit.

Gjykata bazuar në provat e paraqitura, raportin e sipërcituar të administratores së falimentit, dokumentacionin shoqëruar të kësaj kërkesë në tërësinë e tij, ligjin për falimentin nenet 50 e vijues, nenin 60; VKM-në 197 datë 13.4.2007, punën e kryer nga administratorja e falimentit, kujdesin dhe interesin e treguar prej saj në kryerjen e detyrës, punën e anëtarëve të komitetit të kreditorëve, referuar këtu dhe vlerës së masës së falimentit, e çmoi të drejtë dhe të bazuar masën e shpenzimeve të tjera administrative (neni 38 i ligjit), masën e shpërbërimit të caktuar për administratoren e falimentit, anëtarët e komitetit të kreditorëve dhe i miratoi ato në përputhje me nenin 51 të ligjit për falimentin.

Të gjitha sa më lart janë miratuar dhe nga komiteti i kreditorëve, anëtarët e të cilit kanë nënshkruar raportin e administratores së



falimentit dhe listat e shpenzimeve të procedurës së falimentit, të shpenzimeve të tjera administrative, të masës së falimentit, etj.

Kërkesa e administratores u pranua me vendimin gjyqësor nr. 7306/1207 Akti të datës 6.2.2016-vendimi i cili është shpallur publikisht në faqen zyrtare publike të gjykatës (me kufizimet e parashikuara nga ligji-neni 51)-në dosjen gjyqësore ndodhet kopje e njoftimit publik e datës 6.2.2016 dhe kopje e vendimit të arsyetuar. Konkretisht sipas dispozitivit të tij është vendosur:

1. *Miratimin e shpenzimeve të procedurës së falimentimit të subjektit “Arbi-D” sh.a. sipas tabelës bashkangjitur këtij vendimi në masën 1.031.302 (një milion e tridhjetë e një mijë e treqind e dy) lekë.*

2. *Miratimin e shpërblimit për administratoren e falimentimit të subjektit “Arbi-D” sh.a. znj. Mimoza Cara (Memoçi) dhe Komitetin e Kreditorëve në total në masën 1.665.679 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë.*

3. *Miratimin e shpërndarjes së parë të masës së falimentimit në vlerën 10.173.550 (dhjetë milion e njëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë, sipas tabelës së miratuar për kreditorët përfitues, radhës së shpërndarjes dhe vlerave respektive, sipas tabelës bashkangjitur këtij vendimi.*

4. *Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet administratores së falimentimit Mimoza Cara (Memoçi), anetareve të komitetit të kreditorëve, kreditorëve dhe debitorëve.*

5. *Urdhërohet publikimi i këtij vendimi në faqen elektronike të njoftimeve zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

6. *Një kopje e këtij vendimi depozitohet në sekretarinë e seksionit tregëtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

Në vijim të kësaj procedure, nga ana e administratores së falimentimit për pjesën e masës së falimentimit të mbetur pa shpërndarje për efekt të procedurave vijuese, është kërkuar me shkresën dt. 21.2.2017, mbledhja e kreditorëve për shpërndarjen e dytë të masës së falimentimit, e cila sipas tabelës bashkangjitur kërkesës ishte në masën 214.000 lekë. Për këtë shpërndarje ishte mbajtur dhe një procesverbal nga Komiteti i Kreditorëve i nënshkruar prej tyre dhe bashkangjitur dhe tabela e shpërndarjes së masës së mbetur. Në këtë mënyrë nga gjykata në mbledhjen e dt. 17.3.2017, është vendosur:

1. *Miratimin e shpërndarjes së dytë të masës së falimentimit në vlerën totale 214.000 (dyqind e katërmbëdhjetë mijë) lekë, sipas tabelës së miratuar për kreditorët përfitues, radhës së shpërndarjes dhe vlerave respektive, sipas tabelës bashkangjitur këtij vendimi.*

2. *Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet administratores së falimentimit Mimoza Cara (Memoçi), anetareve të komitetit të kreditorëve, kreditorëve dhe debitorëve.*

3. *Urdhërohet publikimi i këtij njoftimi në faqen elektronike të njoftimeve zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

4. *Një kopje e vendimit të arsyetuar depozitohet në sekretarinë e seksionit tregëtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

Pas këtij veprimi në përputhje me kërkesën e administratores së falimentimit dt. 7.4.2017 me rend dite “Miratimin e llogarive përfundimtare të falimentimit për periudhën 17.6.201 deri më dt. 28.0.2017 dhe Mbylljen e procedurës së falimentimit”: në përputhje me urdhërimet e nenit 160 të ligjit për falimentin gjykata caktoi dhe afatin e mbledhjes përfundimtare, i cili u caktua në respektim të nenit 160/pika 2, “Mbledhja përfundimtare e kreditorëve do të zhvillohet më datë 28.4.2017 në orën 14: 00 Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Salla 7, Kati 4”.

Mbledhja përfundimtare u njoftua nga gjykata përsëri për secilin prej kreditorëve si dhe në faqen zyrtare publike të gjykatës më datë 7.4. 2017 (kopja e njoftimit ndodhet në dosjen gjyqësore, duke u respektuar kështu njoftimi sipas parashikimeve të nenit 9 në tërësi dhe vecanti pika 5 e ligjit).

Përpara mbledhjes përfundimtare nga ana e administratores së falimentit dhe anëtarëve të komitetit të kreditorëve në përputhje me nenin 53 të ligjit për falimentin u dorëzuan llogaritë përfundimtare-raporti i datës 28.03.2017 “Për llogaritë përfundimtare të falimentit për periudhën 17.06.2016 deri në 28.05.2013 i cili ishte nënshkruar dhe nga anëtarët e komitetit të kreditorëve (sipas nenit 53 të ligjit).

Në datën 28.4.2017 u mbajt mbledhja përfundimtare e kreditorëve, në të cilën u diskutuan llogaritë e paraqitura nga administratoria e falimentit (raporti i sipërcituar) dhe u kërkuar paraqitja e vërejtjeve lidhur me të dhe listën përfundimtare.

Në këtë mbledhje të gjithë pjesëmarrësit e saj të pasqyruar në procesverbalin përkatës të datës



28.4.2017 nuk paraqiten vërejtje në lidhje me raportin përfundimtar dhe as me listën përfundimtare të shpërndarjes të kreditorët, të miratuar këto të fundit dhe nga gjykata me vendimet e saj të dt. 6.2.2017 dhe dt. 17.3.2017.

Gjithashtu dhe anëtarët e komitetit të kreditorëve në këtë mbledhje nuk parashtuan kundërshtime apo vërejtje-e njëjta situatë dhe për palën debitore, përfaqesuesja e së cilës ishte prezent në mbledhje.

Në mbledhjen përfundimtare pasi u diskutua rreth rendit të saj të përcaktuar në njoftimin e bërë, administratorja e falimentit paraqiti dokumentacionin përkatës në lidhje me realizimin prej saj të mbylljes së shpenzimeve të procedurës së falimentimit si dhe të shpenzimeve të tjera administrative si dhe realizimin e shpërndarjes së fundit të kreditorët e falimentimit sipas pjesëve të pretendimit të kreditorëve të propozuara nga administratorja e falimentit dhe të miratuara nga komiteti i kreditorëve sipas listës së datës 11.11.2016 si dhe nga gjykata me vendimet e saj të datës të dt. 6.2.2017 dhe dt. 17.3.2017.

Sa më lart vërtetohen me “lëvizjet e llogarisë sipas kërkesës” e lëshuar nga Banka Kombëtare Tregtare e dates 01.6.2016-23.3.2017 ku pasqyrohen kalimet të të gjithë kreditorët të likuiditeteve sipas listës së shpërndarjeve të miratuara nga gjykata.

Në kushtet kur në mbledhjen përfundimtare nuk u paraqiten vërejtje ndaj raportit të administratorës së falimentit, ndaj listës përfundimtare të shpërndarjes dhe në respektim të nenit 163 të ligjit për falimentimin, sipas së cilit: *“Sapo të jetë kryer shpërndarja përfundimtare seksioni tregëtar i gjykatës së rrethit vendos mbylljen e procedurës së falimentimit. Vendimi dhe shkaku i mbylljes shpallen publikisht”*,

Nisur nga fakti që nga administratorja e falimentimit është kryer shpërndarja përfundimtare dhe në zbatim të nenit të sipërcituar gjykata caktoi seancën e datës 3.5.2017 mbi mbylljen e procedurës.

Në këtë seancë, në prezencë të administratorës së falimentit dhe të përfaqësueses së palës debitore shoqërisë Arbi-D sh.a., si dhe të anëtarëve të Komitetit të Kreditorëve gjykata, u njoh me qëndrimin e tyre, të cilët kërkuan mbylljen e procedurës së falimentimit pasi është

likuiduar e gjithë masa e falimentit, e gjithë pasuria e saj dhe janë shpërndarë të ardhurat nga likuidimi të kreditorët sipas listës përfundimtare.

Në rastin në shqyrtim nuk u paraqitën pretendime të kundërshtuara, kreditorë me të drejtë ripagimi të veçantë, apo pretendime me kusht për të cilat të mbahej një fond përkatës.

Sa më sipër, gjykata analizon se, ashtu sikurse pasqyruam dhe më lart gjithë masa e falimentit të shoqërisë debitore ARBI-D sh.a. është shitur, gjë e cila do të thotë se jemi përpara likuidimit të të gjithë pasurisë së debitorit; të ardhurat e realizuara janë shpërndarë të kreditorët e falimentimit sipas listës së shpërndarjes.

Në nenin 1 të ligjit për falimentimin përcaktohet se: *“Procedura e falimentimit ka për qëllim të shlyejë në mënyrë kolektive detyrimet e debitorit nëpërmjet likuidimit të të gjitha pasurive të tij dhe shpërndarjes së të ardhurave ose në rastin e një plani riorganizimi nëpërmjet arritjes së një marrëveshje tjetër me synimin kryesor ruajtjen e veprimtarisë së tij.”*

Nga përmbajtja e këtij neni del qartë se janë njohur dhe pranuar dy mënyra të shlyerjes kolektive të detyrimeve të debitorit: a) nëpërmjet likuidimit të të gjitha pasurive dhe shpërndarjes së të ardhurave; b) nëpërmjet plan riorganizimit/ një marrëveshje, që synon ruajtjen e veprimtarisë së debitorit.

Nga përcaktimi i nenit të sipërcituar gjejmë se ligji ynë parashikon/pranon një mënyrë shpëtimit të debitorit, pranohet parimi i shpëtimit të debitorit në rastin e planit të riorganizimit, si një nga alternativat e procedurës së falimentimit.

Në rastin konkret objekt gjykimi nuk ndodhemi përpara një plani riorganizimi i cili i nënshtrohet rregullimeve të parashikuara konkretisht në këtë ligj, por shlyerjes në mënyrë kolektive të detyrimeve të debitorit ARBI-D sh.a. nëpërmjet likuidimit të të gjitha pasurive të tij dhe shpërndarjes së të ardhurave.

Likuidimi i të gjithë pasurive dhe shpërndarja e të ardhurave do të thotë, ndryshe nga plani i riorganizimit, që nuk kemi të bëjmë me shpëtimin e debitorit; pra ky debitor do të likuidohet në tërësinë e tij për shkak të falimentimit-në pasojë ky debitor/shoqëri nuk mund të ruajë me veprimtarinë e tij.

Vet ligji dhe pse jep në nenin 1 të tij qëllimin e procedurës së falimentit dhe mënyrat e realizimit të tij nuk përcakton shprehimisht pasojat që vijnë



nga likuidimi për shkak të falimentimit i debitorit/shoqërisë; nuk përmban dispozita të veçanta mbi pasojat për likuidimin për shkak falimenti lidhur me vetë debitorin shoqëri, gjë e cila passjell dhe zbatimin e dispozitave të ligjit tregtar mbi likuidimin e një shoqërie tregëtare përsa i përket pasojave (ligji për falimentimin parashikon vetëm shpërndarjen e të ardhurave dhe të drejtat e kreditorëve të falimentimit mbas mbarimit të procedurës së falimentimit sipas neneve 164-167).

Ndërsa në ligjin për shoqëritë tregëtare flitet për likuidim të shoqërive në gjendjen e aftësisë pagueuse-i lidhur me gjendjen e mirë ekonomike të shoqërisë dhe trajtohen pasojat që vijnë nga një likuidim i tillë, në rastin e falimentimit të një shoqërie tregëtare me likuidim (bëjmë referim në ligjin tregtar pasi debitori në çështjen në shqyrtim është shoqëri tregëtare) kemi të bëjmë me një likuidim të të gjithë pasurisë së debitorit/shoqërisë i cili vjen/i diktuar nga gjendja jo e mirë ekonomike e tij, i diktuar nga plotësimi i shkaqeve të parashikuara shprehimisht nga ligji për falimentimin dhe që ndodh kur nuk arrihet/dështon përpjekja për shpëtimin e shoqërisë.

Pavarësisht shkakut të likuidimit (vullnetar apo falimentim) në thelb qëndron e njejta situatë: likuidim i të gjithë pasurisë së subjektit/shoqërisë dhe shpërndarjen e të ardhurave.

Në ligjin për shoqëritë tregëtare gjejmë të pasqyruar pasojat që vijnë nga likuidimi në përfundim të tij: prishja e shoqërisë aksionere dhe ç'rregjistrimi i shoqërisë, pasi kemi të bëjmë me një subjekt që nuk mund të vazhdojë me aktivitetin e tij, të cilit tashmë i është likuiduar e gjithë pasuria dhe shpërndarë të ardhurat (neni 187/1/a 202 i ligjit për shoqëritë tregëtare).

Pasojat, prishja e shoqërisë aksionare dhe ç'rregjistrimi i shoqërisë nga likuidimi për shkak falimentimi është i parashikuar shprehimisht në ligjin 9901 dt. 14.4.2008 me ndryshimet Neni 187 i tij sipas së cilit përcaktohet se: *"Shoqëria aksionare prishet: ...b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit; 5. Prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente për procedurat e falimentimit, kur, në përfundim të këtyre procedurave, të gjitha pasuritë e*

shoqërisë janë likuiduar për shlyerjen në mënyrë kolektive të detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente për procedurat e falimentimit vendos rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurisë së shoqërisë për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.

Nga ana tjetër ligji nr. 9723 dt. 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit"- neni 51, i ndryshuar, ligj i cili gjithashtu parashikon dhe rregullon edhe pasojat e ç'rregjistrimit në nenin 53 të tij përcakton se Ç'rregjistrimi me vendim gjyqësor: *"Subjekti mund të ç'rregjistrohet në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë që vendos se subjekti prishet, mbaron apo nuk mund të ushtrojë më veprimtari. QKR-ja ç'rregjistron kryesisht subjektin në bazë të vendimit gjyqësor përkatës, me anë të të cilit vendoset ç'rregjistrimi i subjektit në vijim të ndjekjes së procedurave të likuidimit në rrugë gjyqësore, në rastet kur ligji parashikon procedura likuidimi për këto subjekte, ose në vijim të ndjekjes së procedurave të falimentimit apo të procedurave të tjera që mund të kërkojnë sipas ligjit."*

Nga gjithë sa më lart arrihet në përfundimin se me kryerjen e shpërndarjes së fundit kreditorëve të falimentit të shoqërisë Arbi-D sh.a. mbyllet procedura e falimentimit dhe shoqëria Arbi-D sh.a. tashmë është një shoqëri e likuiduar për shkak falimenti/e falimentuar dhe si e tillë konsiderohet e prishur dhe duhet të ç'rregjistrohet nga rregjistrimi tregtar pranë QKB-së si dhe në pasojë nga të gjitha organet e tjera, si: tatimore, doganore, etj, në të cilat është e regjistruar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata bazuar në nenet 126, 306-308 të K. Pr. Civile, nenin 3, 4, 5, 6, 7, 8, 163 e vijues të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 "Për falimentimin" (i ndryshuar),

VENDOSI:

1. Mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë debitore "ARBI-D" sh.a. me NIPT K62411001D, me seli në adresën Rruga "Bogdani" përballë Shkollës "Avni Rustemi" Tiranë-Shqipëri, me objekt të veprimtarisë së saj në fushën e lojërave të fatit, për shkak të likuidimit të të gjithë pasurisë së saj dhe shpërndarjes së të ardhurave, duke e shpallur si shoqëri e falimentuar.



2. Urdhërohet ç'regjistrimi i shoqërisë “ARBI-D” sh.a. nga regjistri tregtar i shoqërive pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

3. Urdhërohet ç'regjistrimi i shoqërisë “ARBI-D” sh.a. nga Organet Tatimore dhe të Njesisë së Mbikqyrjes së Lojërave të Fatit, si dhe nga të gjitha organet apo institucionet në të cilat është e regjistruar.

4. Urdhërohet publikimi i vendimit për mbylljen e procedurave të falimentimit të debitorit Shoqërisë “ARBI-D” sh.a., në Buletinin Zyrtar të Njoftimeve Publike.

5. Urdhërohet publikimi i këtij vendimi, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në adresën zyrtare në internet të këtij institucioni, në adresën zyrtare në internet të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

6. Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “ARBI-D” sh.a. t'i dërgohet Qendrës Kombëtare të Biznesit.

7. Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “ARBI-D” sh.a. t'i dërgohet Njesisë së Mbikqyrjes së Lojërave të Fatit.

8. Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “ARBI-D” sh.a. t'i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

9. Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “ARBI-D” sh.a. t'i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, si dhe Degës së Doganës Tiranë.

10. Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit të debitorit Shoqërisë “ARBI-D” sh.a., bashkë me raportin përfundimtar të administratores së falimentimit Mimoza Cara, t'i komunikohet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për verifikimin e konsumimit të veprave penale në fushën e shoqërive tregtare dhe të falimentimit.

11. Shpenzimet gjyqësore sipas ligjit për falimentimin.

12. Kundër vendimit lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve, afat ky që fillon sipas ligjit.

U shpall sot më datë 3.5.2017 në Tiranë, ora 14. 43.

SEKRETARE
GencjanaDada

GJYQTAR
Ervin Pollozhani



NJOFTIM I MINISTRISË SË FINANCAVE

Nr. 7601, datë 26.5.2017

DREJTORIA E DREJTIMIT TË PRONËS PUBLIKE

Në zbatim të VKM Nr. 926, datë 29.12.2014 “Për kriteret e vleresimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, Kapitulli III, shpall për shitje me VAM të ulur, si më poshtë:

1. Në administrim të Ndërmarrjes së Prodhimit të Çeliqueve, Elbasan.

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i Ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1.	“Objekti i tharjes së okalinës (objekti nr.54)”	Elbasan	7 264 807.75	6,352,581.75	912 226	3 898.43	1 506.15	20.6.2017	10.00	DDPP
2.	“Kateli”	Elbasan	2 471 226	2 403 600	67 626	289	289	20.6.2017	11.00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave.

2. **Mandat pagesën apo Garancinë bankare** në origjinal që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20 % të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë për llogari të Ministrisë së Financave.

3. **Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim: Pjesëmarrësi në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20 % e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Subjekti i shpronësuar i truallit mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave.



2. **Mandatpagesën apo Garancinë** bankare që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (Mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave.

3. **Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.

4. **Dëshminë e trashëgimisë**, prokurë përfaqësimi etj. nëse ka të tilla.

5. **Deklaratë noteriale**, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish- Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandat pagesa apo Garancia bankare duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarje në ankand. Mandat pagesa apo Garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave pasi të keni tërhequr pranë DDPP ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave www.financa.gov.al



DREJTORIA E DREJTIMIT TË PRONËS PUBLIKE

Në zbatim të VKM Nr. 926, datë 29.12.2014 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, shpall për shitje me vam fillestar si më poshtë:

SHOQËRITË HUAMARËSE NË ADMINISTRATIM

1. Pronësi të Shoqërisë “Kamberi” në administrim

Nr.	Emërtimi	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i Ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Linjë sallami, makineri	Ish-Pularia, Nartë, Vlorë	258 400	258 400				21.06.2017	10.00	DDPP
2	Gjenerator	Pranë zyrave të Shoqërisë Huamarrëse, Tiranë	110,000	110,000				21.06.2017	11.00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndermarjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave.

2. **Mandat pagesën apo Garancinë bankare** në original që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20 % të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë për llogari të Ministrisë së Financave.

3. **Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shenim: Pjesëmarrësi në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20 % e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Mandat pagesa apo Garancia bankare duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandat pagesa apo Garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave pasi të keni tërhequr pranë DDPP ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave www.financa.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2017